REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr/Br. 823/20
Datë/Datum. 09.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.823/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Z. Blerim DINA - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "AWA"SH.P.K.-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE "Gurri Marketing" SH.P.K. dhe "Solvit" SH.P.K-Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me material promovues (protokollar), për UHZ " me nr. të prokurimit: UHZ-20-1532-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "Universiteti Haxhi Zeka Pejë", më datën: 12.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "AWA"SH.P.K,-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me material promovues (protokollar), për UHZ" me nr. të prokurimit UHZ-20-1532-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - "Universiteti Haxhi Zeka Pejë".

II. **ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me material promovues (protokollar), për UHZ " me nr. të prokurimit: UHZ-20-1532-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "Universiteti Haxhi Zeka Pejë", dhe lënda të kthehet **ne Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "AWA"SH.P.K-Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues "AWA"SH.P.K,-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 19.10.2020 me nr. 823/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material promovues (protokollar), për UHZ " me nr. të prokurimit: UHZ-20-1532-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "Universiteti Haxhi Zeka Pejë", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60 dhe 72.3 të LPP-së, si dhe neni 39 dhe 41 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 26.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 27.10.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:
Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues – Universiteti "Haxhi Zeka" -Peje, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim (kornize 24 muaj), me vlerë të mesme. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për dhënie te kontratës, përkatësisht kundër arsyetimit te eliminimit pas ri vlerësimit te ofertave, ku AK përmes letrës standarde, te datës 02.10.2020 tekstualisht ka potencuar: "Ne ofertën tuaj mungon certifikata e TVSH-se" Parashtruesi i ankesës te njëjtin arsyetim e ka kontestuar përmes kërkesës për ri shqyrtim, mirëpo AK-, përmes Vendimit e ka refuzuar te njëjtën dhe e ka lenë ne fuqi vendimin e saje për dhënie te kontratës, përkundër asaj qe Paneli shqyrtues tani me ketë pretendim e ka gjykuar përmes vendimit me numër. 431/20.

Përgjigje në Pretendimin ankimore : (Neni 113)
Pas administrimit dhe shqyrtimit te shkresave te lendes kundrejt pretendimeve ankimore sqarojmë se AK, edhe tani pas ri vlerësimit te ofertave parashtruesin e ankesës e la eliminuar me arsyetimin e njëjte si ne

vlerësimin fillestar. Ne përmes raportit paraprak, kemi sqaruar se parashtruesi i ankesës se bashku me ankese kishte prezantuar kopjen, certifikatën – Deklarues i TVSH-se ne emër te AWA SH.P.K me nr, 330429870 dhe nr fiskal 811345976, regjistruar me datën 04.09.2019. I njëjti pretendim është gjykuar edhe me vendim nga paneli shqyrtues, rrjedhimisht AK, nuk i ka respektuar rekomandimet e dala me vendimin me nr 431/20, i datës 07.08.2020, prandaj e njëjta qeshje ne kuptim te nenit 16, par 3., te rregullores se punës se OSHP-se nr, 01/2020, tani me është gjykuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet si e bazuar, të anulohet propozimi për dhënie te kontratës, dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim.**

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 27.10.2020 me raportin e ekspertizës.

Operatori Ekonomik "AWA" SH.P.K-Prishtinë me datë 31.10.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 12.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "AWA"SH.P.K.-Prishtinë, se AK përmes letrës standarde të datës 02.10.2020 e ka eliminuar OE ankues me arsyetimin se në ofertë i mungon certifikata e TVSH-së. Parashtruesi i ankesës të njëjtin arsyetim e ka kontestuar përmes kërkesës për ri shqyrtim. Mirëpo, AK përmes vendimit e ka refuzuar të njëjtën dhe e ka lënë në fuqi vendimin e saj për dhënie të kontratës.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK edhe tani pas ri vlerësimit të ofertave, parashtruesin e ankesës e ka eliminuar me arsyetimin e njëjtë si në vlerësimin fillestar. Paneli Shqyrtues sqaron se edhe në raportin paraprak të ekspertit shqyrtues dhe vendimit të panelit shqyrtues është sqaruar sqaruar se parashtruesi i ankesës se bashku me ankesë kishte prezantuar kopjen, certifikatën – Deklarues i TVSH-së në emër të AWA SH.P.K me nr. 330429870 dhe nr. fiskal 811345976, regjistruar me datën 04.09.2019. I njëjti pretendim është gjykuar edhe me vendim nga paneli shqyrtues. Rrjedhimisht, AK nuk i

ka respektuar rekomandimet e dala me vendimin PSh.nr.431/20 të datës 07.08.2020. Andaj, urdhërohet AK që ti merr parasysh sqarimet e dhëna në këtë vendim dhe në vendimin paraprak.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se AK nuk ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP-së, duke mos bërë ekzaminim, krahasim dhe vlerësim të drejtë të tenderëve. Andaj, urdhërohet AK që të kërkoj sqarime shtesë lidhur me certifikatën e TVSH-së dhe të bëjë ekzaminimin e drejtë të tenderëve në abzë të kërkesave të dosjes së tenderit dhe në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Në të kundërtën, AK e obligon Panelin Shqyrtues që të marr masa konform dispozitave ligjore të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "Universiteti Haxhi Zeka Pejë";

1x1 OE "AWA"SH.P.K,-Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb faqe të OSHP-së.